



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilajene Mirënjohje 28-04-2021 vit.gj.
Nr./i organit: Shitja e Vlera
Org./brej: n. Vrednos:

01-110/05-261



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.04.2021, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 31.03.2021

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin e mbledhjes së tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 31.03.2021.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 31.03.2021.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.03.2021 (e Mërkure) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, Kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Bajram Sokoli, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Lindita Demelezi, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idriizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike, zyret e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Zyra Ligjore e MAPL-së naj ka konfirmu konfirmimin e ligjshmërisë e të gjitha akteve që i kemi miratu në seancën e kalume, disa janë të kundërligjshëm që ne këtë seancë duhet me i shfuqizu, një e kemi plotësim ndryshim. Kryesuesi i njoftoj edhe rreth situatës me Covid 19. Meqenëse sot ne kuvendin komunal i kemi edhe dy anëtarë të ri. Unë fillimisht kisha dashtë që këta ta bëjnë betimin dhe të fillojmë me pika të tjera të kuvendit. I lus dy anëtarët e ri që të ngritën në kam, qe unë ta lexoj deklaratën: “Bazuar në nenin 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 24, paragrafi 24.6 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, në nenin 4 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim: Unë _____, “beto hem (ose deklaroj solemnisht), se do t’i kryej me nderë, besnikëri, pa anim e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Beto hem!” Urime, paqit fat dhe shëndet. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet, fjala është për ju.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, këshilltarëve të ri ju uroj, dëshiroj suksese në punën e kuvendit. Pyetje kam për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kemi pa punimet që janë bërë në rrugën “Hidromorava” që i ka bërë për ujësjellësit. A është bisedu për kompaninë për kthimin e rrugës në gjendje e mëparshme, se ashtu qysh është, është në gjendje shume të keqe. Pyetje tjetër e kam për drejtoreshën e shëndetësisë. U bërë shumë bujë këtu për autoambulancën, a është kthyer autoambulanca ne QKMF-në në Pozharan.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Këshilltarëve të ri ju uroj, dëshiroj suksese ne punën e kuvendit. Unë kam një pyetje: rruga prej "Lisit" e deri tek rruga e ambulantes është katastrofë. Aty një shi si të bien, uji nuk ka të qarkullon. Shumë herë e ka potencu edhe Vehbia, keni thanë që keni me ndreq e hala nuk keni ndërmarr asgjë.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Është seanca e pestë që e kërkojnë nga Drejtoria e Shëndetësi listën për shërbimet e Karitasit, për cilët punëtor janë duke u paguar. Do ta kërkojnë këtë listë deri sa të ma sjellni. Kam pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, tek ndërtesa e verdh, pjesa e podrumit është e mbushur krejt me kanalizim, ka kundërmim të jashtëzakonshëm, është aty shumë problematike. Pse ajo nuk mirëmbahet ose a keni ndërmend me ndërhy aty, sepse ish në gjendje të mjerueshme. Pjesa e podrumit tek ndërtesa e verdh, e kame një pyetje edhe për drejtorin e kulturës, lidhur me stadiumin ne Viti, pranimi teknik e kërkojnë për seancën e radhës me ma sjellë pranimin teknik që është bërë punimeve te stadiumit, ndërsa cilat janë obligimet e klubit për deri sa komplet në stadium investohet prej komunës, ndërsa klubi është privat, klubi i Vitisë është i privatizuar. Cilat janë obligimet e klubit, pasi që është i privatizuar ndaj komunës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kam dy pyetje, njëra ka të bëjë me zgjerimin e rrugës në fshatin e Smirës, a mujmë me ditë se kur përfundon ky projekt, sepse në vjeshtë ka fillu, edhe shumë telashe ka sjellë për banorët e po dojmë me ditë kur përfundon ajo. Pyetja e dytë ka të bëjë me trotuarin në Germovë, pasi që disa banor atje ankohen se ndriçimi publik nuk ka togëzim dhe kjo është rrezik për qytetarët. Kërkoj një përgjigje nëse rrezikohen qytetarët atje.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë kam parapa një kërkesë për drejtoreshën e shëndetësisë, që është e njëjtë me të Bekimit, po unë po bëjë kërkesë, që të me silltet në seancën e radhës një specifikacion për vitin 2020 dhe për dy muajt të vitit 2021, se çka parasheh kjo kontratë apo kush paguhet nga kjo kontratë. E di që ekziston një kontratë mes komunës dhe Karitasit, po megjithatë një specifikacion se çka, kush paguhet nga kjo kontratë dhe një pyetje për ndërtimet pa leje, se çka është ndërmarr dhe ku ka mrri qështje e di që janë ndërpre, po unë po shohë çdo ditë punime, aty si qëndron puna, edhe du me ju përgëzu drejtoreshën e shëndetësisë për ambulancën që e keni kthy.

z.Sejdi Emiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Uroj shëndet për dy anëtarët e ri të kuvendit komunal ajo që më bëni përshtypje, sot ke edhe ajo që paskan fillu edhe këta me bërë kritika me pëlqye, sepse ky është parim i anëtarit te kuvendit me 24 mars është mbajtur një orë letrare për nder të "Flakadanit të Karadakut". Drejtori i kulturës aty nuk ka pas fare kushte, as elementare për mu mbajtur ajo ore u kane temperatura minus, ku kanë ardh prej të gjitha trevave aty shkrimtar dhe në qatë gjendje të mjerueshme me i lanë, është kanë e turpshme, sepse edhe unë jam qu ne gjysmën i kamë lanë, sepse nuk ka pas kushte elementare, ka qenë temperatura minus, ku kanë ardh prej të gjitha trevave aty shkrimtarët dhe në qatë gjendje të mjerueshme me i lanë është punë e turpshme sepse edhe unë jam qu ne gjysmë kam dal. Drejtori i inspeksionit tash po dihet që është edhe kohë pandemie, shumë herë po hasim ne kafshë të ngordhura nëpër vende të ndryshme, a ka ndonjë vend specifik ku banorët e Komunës së Vitisë mund t'i qojnë këto kafshë, t'i groposin në mënyrë që mos hapet pandemi dhe ta dini adresën se ku ata e kane vendin e caktuar për këtë gjendje. Kam edhe një kërkesë ku një urë ne Binç aty ka qarkullim aq shumë, është urë shumë e rëndësishme, sepse lidh edhe fshatrat Debellde-Bozovik dhe Shushtë, ka nevojë për zgjerimin e asaj ure mu bë për dy makina, sepse komunikacioni mjaft është i ngarkuar aty. Drejtor i arsimit, e kemi një kërkesë disa parkingje të automjeteve tek shkolla, ta kemi bërë me shkrim ne si shkollë, të kam thanë privatisht ku jemi taku, mirëpo ajo është e nevojshme, sepse aty ka rrezik për nxënës dikun 10-12 vetura janë të arsimtarëve e dikun 20-30 janë të prindërve, që i bien fëmijët dhe po bëhet kaos në vend. Kushte kemi kriju për me qit zhavorr ne dy hymjet, ne si fshat i kemi kriju kushtet, kështu që po kërkoj me marr masa dhe me e pru zhavorrin për me kriju kushte normale për me i ik rreziqeve. Sa i përket ambulancës, dikun para 7 muaj e kemi kërkuar parimisht pa politik për ne Pozharan.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë e kam një kërkesë për drejtorin e inspektoratit, po edhe për drejtorin e shërbimeve publike. Pluni këto ditë është ka na mytë, edhe kompania që ka punu shumë i ka lan keq riparimet, gropat septike kanë fjet. Ju keni thanë që keni me fillu në Mars me i rregullu, tani jemi në Prill, mundësish me fillu me shpejtë. Tjetra, ku do tani me e marr një automjet e me dal në Viti, në fshatra me e fotografu bërlllogun, është ka gjuhet kudo. Sejda i përmendi edhe kafshët e ngordhura, po nuk po du me i cek këto, ama bërlllog gjithkah keni. Nëse nuk besoni dal i fotografoj, edhe i shini. Unë i kontrollova tri vite mbrapa, na i kemi nja dy tipe të kontratave që po ndajshin nga 400 mijë euro mjete të zotuara për mirëmbajtje, larje të parqeve, rrugëve, trotuareve, 400 mije euro dikun për dy vite edhe një tjetër ish 100 mijë, d.m.th janë pare shumë e madhe edhe mos me mujtë me u mirëmbajt rrugët e mu hedh bërlllogu kudo, nuk është në rregull, kisha kërku me qenë me të kujdesshëm.

z.Nuredin Luftiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kryesues, e kame një pyetje për ju, pse nuk rregullohet zgjerimi në sallën e kuvendit, gati po bëhet 7 vite që nuk rregullohen, i kame disa kërkesa nga banorët e fshatit Skifteraj, të cilët kërkojnë nga qeverisja lokale të përmbushen premtimet elektorale, si premtimi për ujë të pijshëm, po jo mu kthy uji i pijshëm prej puseve të "Moravës", po mu bë lidhja me fshatin Letnicë, asfaltimi i rrugës 17 Shkurti dhe 15 Prilli, të behet shtrimi me tretuar i rrugës së xhamisë së vjetër, rrugës "17 Shkurti" dhe "15 Prilli", rrugës "Metush Ismajli", "Feriz Rama" dhe rruga "Flakadanët e Lirisë" dhe ka qenë një premtim vendosja e një trafo në një prej lagjeve në lagjen "15 Prilli", ku aty është rryma shume e dobët, është e pamundur, çdo që është elektrik dhe nuk ka mundësi te punohet aty, sepse rryma është shumë e dobët, banoret kërkojnë ata e kane parasysh se KEDS-si është kompani private, po kërkojnë atë që ju ka premtu që do të ndihmohen.

znj.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Dy anëtarëve të ri ju dëshiroj suksese, unë kam dy kërkesa që janë me së të domosdoshëm për qytezën e Pozheranit, janë dy rreth rrethrotullime, njeri është tek rruga e shkurt e Pozharanit që lidhet me Vitinë, ku frekuentimi është shumë i madh dhe numri i aksidenteve është shumë i madh, po mase i domosdoshëm. Është edhe një vendrotullim tek shkolla e mesme, aty edhe nxënësit janë të dy shkollave, edhe rruga që lidh me Sllatinë, faktikisht aty vetëm kohën e fundit po muj me thanë që është më shume se 5-6 aksidente. Unë i di, vetëm këtë vit, po fatmirësisht nuk kanë përfundu me fatalitet, kështu që mbes me shpresë që do te bëhet diçka në këtë drejtim.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. I uroj punë të mbarë dy asamblistëve. Unë kam një pyetje, po më doket që drejtori i shërbimeve publike, z.Nexhmedin Jakupi është lodh nga kjo punë, e Vitia sot është në kauzë prej bërlllogu. Është e treta herë që në këtë kuvend kam thanë edhe po e thamë prapë si shqetësim të qytetarëve, tek rruga "Adem Jashari", mbrapa banesave të vjetra përball policisë, i ki si me shku në Fallugja, eshë bë si deponi e bërlllogut. Nuk e di a je tu i marr kërkesat ose pyetjet e këshilltarëve komunal, a shkon në vendin e ngjarjes, beso që ka ankesa prej banorëve aty. I nderuari kryesues, na e dimë që e kemi dhënë një tender për dezinfektues, këtu në kuvend nuk ka hiq dezinfektues, ku janë dezinfektuesit. Zotëri Ramiçi, për qat urën që shumë herë ju kërkoj dokumentet, kurr nuk mi jep.

z.Zekirja Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Unë e kam një pyetje, deshta ta pyes drejtoreshën, se kur do të vinë vaksinat dhe kush do të vaksinohet i parë. Fjalën e kam për vaksinat për Covid 19.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Këshilltarëve të ri ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë. Kam një pyetje dhe një kërkesë, pyetja është për zv.kryetarin e komunës, kur qytetarët e Vitisë do të furnizohen me ujë nga gypat e ri që është bë me te vërtet histori kjo punë. Edhe rruga Skifteraj - Stubëll e Poshtme, kisha kërku që ingjinerat e juaj ti qitni në teren dhe ta shikojnë atë rrugë, se me të vërtet është dëmtu shumë. Besoj që si ta shikojnë ingjinerat, e besoj që punëkryesi e ka kontratën hala për me e kry, kështu që sa më shpejtë të dilni në teren që mos ti përfundon kontrata punëkryesit.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kolegeve të ri ju uroj punë të mbarë e suksese. Nënkryetar, si qëndron puna me tregun e gjelbër në komunën tonë. Jemi një ndër komunat që tregun e kemi me

kushtet me të pa përshtatshme, kemi mungesë të elementeve bazë, si p.sh.: tregtarët aty nuk kanë ujë të pijshëm e tualet. Kur do të ndryshon kjo? Gjithashtu edhe stacioni i autobusëve në Viti, pse ka mbet pa u funksionalizu, ku aty ju ofrojmë shërbime qytetarëve e nuk është i shfrytëzueshme nga operatorët e transportit të nxënësve dhe udhëtarëve, që gati 8 vite qeverisje. Kur ka me ndryshu kjo gjendje.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Kenë edhe dy pyetje. Për mu njëra ke për zërimin në sallën e kuvendit. Unë e di që procedurat kanë përfunduar, tenderin e ka marr një operator, po shpresoj shumë që në seancën e radhës do të jenë të vendosura mikrofonat. Dhe pyetja tjetër ishte nga Taulanti, që me të drejtë që nuk kemi prurje dezinfektues, ndërsa ekipën mjekësore e kemi pas këtu.

z.Nexhmedin Jakupi, drejtor i shërbimeve publike: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ishin disa pyetje, e para ishte rreth një projekti të “Hidromoraves”, e cila e ka bërë një shtrirje të gypit për ujësjellësin që do të furnizon Smirën edhe Verbanin dhe në disa pjesë të qytetit gropa është e vërtetë që shumë vonë, dimër, janë mundu me e kthy ne gjendje e mëparshme ku kane intervenu me asfalt dhe ne i kemi dhënë vërejtjet e tona. Edhe Drejtorja e Inspeksionit po edhe ne si drejtori nuk ju kanë pranuar punët nga “Hidromorava”, prandaj kanë mbetur në obligim. Tash Pranverë, me përmirësimin e kohës që t’i riparojnë ato defekte që janë. Edhe ne si drejtori do të kërkojmë që ti kryejnë ato pune. Pyetje tjetër ishte rreth ndërtesës së verdhë. Është e vërtetë që ai objekti është i komunës, jetojnë qytetarët aty që nga pas lufta. Drejtorja e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me “Hidromoraven”, që sa jam unë drejtor, dy tri herë kemi intervenu atje, e kemi pastru edhe këtë vit. Unë po bëj përpjekje që me insistu me ata qytetar me majtë një takim, pasi që jetojnë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve në atë banesë. Asnjë prej tyre nuk i përgjigjet kompanive të cilat kryejnë shërbime, po mendoj as kompanisë “Eko Higjena”, as për mbeturina, i hedhin mbeturinat, nuk paguajnë për mbeturina. Unë me qytetarët që jetojnë në atë lagje kam kërkuar një takim që ta mbaj me ata që njëherë e përgjithmonë ta zgjidhmi atë problem. Ne si komunë nuk kemi obligime me ja mirëmbajt banesën, ne po bëjmë përpjekje që t’i riparojmë qato probleme që po na paraqiten. Shpresoj që shumë shpejt do ta kemi një takim me ata qytetar. Jakupi e bëri një pyetje rreth tokëzimit, nëse behet fjalë për tokëzimin në rrjetin e ndriçimit publik, rrugës Smirë-Sadovinë, tani ajo e kemi rregull tokëzimin aty. Sameti e bëri një pyetje, po është e vërtetë se të gjithë ne si qytetar të Komunës së Vitit edhe unë si drejtor e kam ngrit këtë çështje kur është diskutu për ambientin, vërtetë është në gjendje, nuk jemi për lavdata po jemi për kritikë. Unë mendoj që këtë problem nuk mund me zgjidh vetëm një drejtor ose komuna, duhet të vetëdijesohemi si qytetar, kompania operon në të gjitha lokalitetet, me përjashtim të Buzovikut. Këshillat e fshatrave, edhe Taulanti e bëri një pyetje, e ka ngrit edhe disa herë këtë çështje, po po ju përgjigjem që disa here, kemi intervenu në atë pjesë, po kërkush nuk shkon me ja marr në banesë mbeturinat kërkujna. 10 metra prej atyre banesave i kemi 3 kontejnerë, për qata janë kontejnerët, për qata është mirë që ata qytetar me pagu për mbeturina edhe me i qit në kontejnerë, sepse as kamioni nuk hyn në atë pjesë aty.

z.Ibrahim Rama drejtor i financave: Përshëndetje të nderuar këshilltar komunal. Një pyetje nga këshilltari Bekim Aziz lidhur me stadiumin në Viti. Hala nuk kanë përfunduar procedurat, pranimi teknik, besoj që afër jemi të përfundimit të këtij projekti, që është mjaft interesant për sportistët në nivel të komunës, sidomos për ekipet që garojnë në futbollin e madh, kështu që me përfundimin e projektit me pranimit teknik, sigurisht që dokumentacionin e saktë dhe të plotë mundeni me pas në disponim. Një pyetje tjetër lidhur me zgjerimin e rrugës në fshatin Smirë. Po është projekt dyvjeçar, ju e dini që edhe buxheti kur është miratu është miratu edhe për vitin 2021. Pjesa e punëve të cilat kanë mbetur pa u kryer në vitin 2020, buxheti është, e unë besoj që edhe ky projekt do të përfundon ashtu siç është projekt me projektin final. Taulanti shumë herë e ka bërë të njëjtën pyetje, ju kam përgjigjur shumë herë, pjesën e informatave që kanë të bëjnë me ndërtimin e urës tek shkolla e mesme. Unë njëherë ti kam siguruar shënimet, kurse për dosjen complete të kam thanë, ajo ekziston në Zyrën e Prokurimit, komplet dosja e fillimit të procedurave dhe të përfundimit të këtij projekti. Të kam thanë bane një kërkesë me shkrim dhe do ti kesh të gjitha informatat, përndryshe statistikën që ekziston kuptimin e financave të pagesave të

përgjithshme, ti kam sjellë, jam shumë i sigurt për këtë, po ti është mirë me bë kërkesën me shkrim.

z.Skender Ahmeti, drejtor i Inspeksionit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ishin nja dy tri pyetje që kishin të bënin me drejtorin tonë, në këtë rast Remzi Salihu pyeti për ndërtimet pa leje. Ne si drejtorat i inspektoratit, i kemi shterr të gjitha procedurat administrative që i përket ligjit të ndërtimit dhe tash çështja është duke u hetuar në organet tjera, siç është prokuroria dhe policia, prandaj këtë çështje nuk dëshiroj ta diskutoj me tepër, për shkak se janë tu marr organet tjera. U diskutu nga Sejdi Emini për kafshët e ngordhura në Komunën e Vitisë, me bindje të plotë thamë Sejd, se asnjë kafshë e asnjë fermeri që ngordh. Ne ju kemi përgjigj në mënyrën më të mirë të rregull, të gjitha rastet që ka pas ngordhje të kafshëve, ne ju kemi përgjigj, kemi edhe varrezat e kafshëve të cilat ngordhin, ne kemi mungesë në anën veriore të Komunës së Vitisë me planin e ri zhvillimor komunal, me çdo kusht kam kërku që ti kemi dy vendvorreza për kafshët shtëpiake, një ne pjesën veriore e një në pjesën jugore, sepse ne kemi të bëjmë edhe me kafshët e asgjësuar që kanë sëmundje të cilat rrezikojnë edhe shëndetin e qytetarëve, edhe pse me rastin e ngordhjeve të kafshëve duhet të bëhet një pagesë sipas rregullores komunale, por ne edhe atë nuk e kemi kërku nga asnjë qytetar, për shkak të demit që ju ka bë në ekonominë familjare. Tek çështja e mbeturinave pyeti Sameti. Është e vërtet që çështja e mbeturinave është sfiduese, jo vetëm për organet komunale po edhe në nivel të vendit, por vetëdijesimi që e përmend drejtori i shërbimeve publik, është nëse ne bëjmë sanksionime sa më shumë e për ti rritur sanksionimet. Ne kërkojmë bashkëpunim edhe nga ju edhe nga qytetarët. Ne pramë e kemi pas një dhezje të gomave dikun në orët e vona në fshatin Ramnisht dhe policia e ka pas rastin, na ka thirr neve dhe ne tash do ta inicojmë procedurën, do ta sanksionojmë me çdo rast që shihet dikun që dikush po hedh ose po djeg mbeturina. Ne e kemi çështje që e mbrojmë çdo lajmërim e çdo gjë do ta sanksionojmë për shkak se kjo është pasoj e shëndetit tonë dhe asnjë rast nuk do ta tolerojmë. Ne kemi rast kur thërrasin nga perëndimi se po hedhin mbeturina, p.sh.: në Drobesh dhe pas një gjysmë ore thirr i njëjti pronar e keni zanë, po të lutem mos na prishin si familje, tash po tërhiqem. Jo tash nuk tërhiqni se ma nuk ka autorizim kërkush mu tërhiq, kur të lajmërohet rasti do të shkojmë deri ne fund, asnjë rast nuk do ta lëshojmë pa e sanksionu. Ju kisha lut që çdo rast që e shini tu hedh mbeturina apo tu djeg, lajmëroni, jemi ne përkrahje të juajin.

Znj.Hanife Januzi, drejtoresh e shëndetësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Pyetjen që e bëri Aliu, autoambulanca u ardh, defekti ka qenë vetëm me dokumentacione, asnjë moment nuk ka qenë ndonjë problem tjetër, vetëm probleme teknike. Sa i përket pyetjes së Bekimit, edhe më herët e ke të njëjtën përgjigje, ke të drejt në qasje në dokumente, po ta kisha unë në dorën time, ato do ti kisha sjellë, mirëpo tek unë nuk gjinden ato. Keni të drejt të bëni kërkesë në dokumente zyrtare dhe mi marr ato. Edhe profa Remzi pat pyetje, listën e Karitasit, prapë edhe ju mundeni me marr këtë, po ne kemi nevojë për staf mbështetës, kemi nevojë për motra medicinale, kemi nevojë për mjek, kështu që kemi kontratë me tender përmes komunës e Karitasit, që aty ti kemi ata punëtor, mirëpo pagesa për ata normal nga komuna. Zeka pyeti kush do ta merr vaksinën e parë, vaksinën e parë kanë të drejt së pari ta marrin punëtorët shëndetësor, pastaj mbi moshën 80 vjeçare edhe të gjithë popullata, mirëpo me dhunë askush nuk e merr vaksinën.

z.Milot Lala, drejtor i kulturës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Bekimi kishte pyetje lidhur me pranimin teknik dhe obligimet e klubit ndaj Komunës së Vitisë. Sa i përket pranimin teknik e tha drejtori i financave, që pranimi teknik ende nuk është bë, për obligimet e klubit ndaj Komunës së Vitisë ne e kemi rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike për klubet që e shfrytëzojnë. Dihet që klubi i “Vitisë”, prej momentit që është privatizu, ne nuk e kemi mbështet me subvencione, por e kemi leju që ta shfrytëzon hapësirën e stadiumit. Dihet që klubi i “Vllaznisë” dhe klubi i “Vitisë” janë dy ambasadorët me të mirë të Komunës së Vitisë dhe ju së bashku me mu ka qenë dashur me kërku me i mbështet më shumë e jo me kërku që me ju marr klubeve, me ja vështirësu sa më shumë punët. Sa i përket pyetjes së dytë që e bëri Sejda, rreth orës letrare. Sejdë, në seancën e radhës e kemi raportin rreth “Flakadanit të Karadakut”, e kështu që do të përgjigjem ne pyetjet.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Këshilltarëve të ri ju dëshirojmë suksese. U parashtruan disa pyetje, po pjesën dërmuese u përgjigjen drejtorët. Unë do të përgjigjem në disa që nuk u përgjigjen drejtorët, si çështja e zgjerimit të urës në Binç. Me të vërtetë e kemi pa edhe ne si pushtet, po nganjëherë përkundër dëshirës, mundësitë nuk lejojnë me bë shumë, por në prioritetet tona është kur do ti vjen hapi apo mundësia e zgjerimit. Çështja e parkingjeve. Unë e di që aty është bë një pune e mrekullueshme e komunës, ka pas edhe mirëkuptim edhe nga ana e qytetarëve, që duhet me i falënderua për këtë, atë besoj që atë çështje, ndoshta nuk është e nivelit të inspektorëve me ardh me i rregullu çështjet e parkingjeve, e sa i përket rërës, besoj që nuk ka me pas problem, se jep edhe një jeshi vet objektit dhe nxënësve që mësojnë aty. Nuredini shtroj shumë pyetje, në mesin e pyetjes ishte s'bashku me Ekremin ne aspektin e gypit kryesor. Nura për Skifereraj për ujë. Ekrem, nëse diçka mu ka bë monoton, është çështja e nënkryetarllëkut. Është çështja e "Hidromoravës" me CDI-në, po ta thamë me plotë kuptimin e fjalës, në 15 ditshin e fundit i kam pas dy takime të rënda dhe kemi arrit pak me e stabilizu, po gjithherë nuk po muj me ju besu që do ta arrijmë atë që po dëshirojmë ne si udhëheqës. Po e thamë në tërësi me ju njoftu, se kemi pranu me kryetarin e komunës se shume prej juve e keni shtru këtu me plote te drejt, pse nuk po ndani pare për ujë të pijshëm me e mbulu Vitinë, ju e dini se ju jeni kanë ata miratuesit e buxhetit të kuvendit komunal, një shumë bukur të konsiderueshëm e kujtoj dikune 400 mije apo se di sa ka qenë shifra e saktë e participimit të projektit dhe gjithherë ne kemi aludu se duhet me i qu në ujë ti ti mbulojmë krejt qytetarët e Komunës se Vitisë. Shumë ran po na shkon, çështjen duhet ta pranojmë dhe ne dy takimet e fundit jemi dakordu se me ardh me një marrëveshje konkrete, tu fillu nga Remniku ne Trestenik, asnjë fshat mos me e lan pa e përfshi, po me i përfshi varësisht se cila çka ka nevojë. Në rast që me një lokalitet kemi nevojë krejt mu marr me ujësjellës e në Remnik sa i përket rrjetit te brendshëm e kemi, duhet me gjet gypin kryesor edhe ujin edhe me fillu. Në Goshicë jemi në fazën tjetër të cilën po e njoftoj Sejden kemi bë kërkesë që me gjet ata bile nja dy tre vende me be ata shpimin, që me mujt gypat, se na nuk kemi asi makeneria e që ata me shpu e me mujt qytetarët mu lidh me fillu me leshu ujin. Krejt këto nuk po guxoj me ju thanë po i kam me data të shënuar që kam kërku mu kry. Ka qenë edhe një këmbëngulësi e drejtorit regjional të "Hidromoraves", që na ka përkrah në këtë drejtim, po qaq është mundësia e tij, sepse implementuese e krejt këtij programi është CDI-ja. Unë po shpresoj që do të na vinë ditë më të bardha e me të mira, sepse vullnetin e kemi. U përmend edhe tregu i gjelbër edhe stacioni i autobusëve. Për tregun e gjelbër kemi problem edhe të pronësisë, nuk është pronë e jona. Jemi tu punu shumë në këtë drejtim me mujt me bë ndërrim të pronës tu fillu edhe ish objekt i zjarrfikësve, shkolla fillore, varrezave të dëshmorëve, krejt sa të mujn me mrri. Jam tu e lut sa më shpejt me hec procedurën se bashku me përfaqësuesin e AKP-se, të bëjmë diçka dhe masanej të shikojmë edhe mundësinë e investimeve. Nuk po du me i kontestua ato që i thave, sepse është gjendja reale, ashtu që nuk kanë kushte për zhvillim të veprimtarisë. Stacionin e autobusëve. Ju e dini që ne kemi intervenu ne, kemi pas ardh me një marrëveshje, këtu nuk kemi has në mirëkuptimin e juaj, nuk kemi kapacitetet që e marr një administratë në stacionin e autobusëve në Viti. E kam shiqu mundësinë edhe ata bashkimi e tri kompanive të cilët në këtë rast operojnë stacionin autobusëve, "Hidromoravën", "Ekohigjenën". Për momentin nuk ka mundësi me pas mirëkuptimin e juaj, unë jam në disponimin me pru atë marrëveshje me e votu, edhe me ja dhanë e me ju kriju kushte njerëzve. Stacioni i autobusëve nuk mundet me ta majt stafin administrativ me sa krijon të hyra stacioni i autobusëve në Viti, e në rast që ju keni mirëkuptimi unë në mbledhjen e radhës e bi e me të vërtet nuk e la në atë gjendje që unë jam, për ata e nënshkruajmë një marrëveshje të mirëkuptimi, ja japim Gjilanit.

z.Bekim Azizi: Për drejtorin e kulturës. E di që objekti nuk është i komunës, mirëpo me mirëmbajt e keni obligim dhe sikur çdo vend që duhet mu mirëmbajt, nuk është i komunës as stadiumi i shtetit, është i AKP-së, mirëpo janë investu 500 mije euro aty edhe aty e shfrytëzon një klub privat që drejtori thotë në vend që me na nimu thotë unë po kërkoj me e ngarku ata. Unë asnjë kërkesë për ngarkim nuk e bëra, unë kërkoja, cila është marrëveshja e komunës kur të ja jep dikujt ne shfrytëzim që investon me një stadium 400-500 mije euro edhe ja

jep dikujna një klubi privat, cila është marrëveshja e shkruar, duhet me pas një marrëveshje, jemi institucion, e ki obligim me pas marrëveshjen e shkruar, a e ka që me mirëmbajt stadiumin ai a e ka të hyrat që i realizon, të ndahen, e ki për obligim, tama edhe stadiumin e ki të privatizuar, sepse aty nuk guxon me hi askush përveç klubit, a d.m.th stadiumi është i qytetit, i komunës, komuna ka investu aty, duhet me i shfrytëzu edhe klubet tjera. Unë kërkoja një dokument të shkruar, a e ki. Unë absolut nuk kërkoja me e ngarku atë, as me ja ndal veprimtarinë, mirëpo kërkoja një dokument të nënshkruar që e ka në shfrytëzim atë stadium klubi "Vitia".

z.Taulan Haxhiu: I nderuari drejtor Jakupi, aty ku unë po thamë dhe tek rruga "Adem Jashari" mbrapa ndërtesave, ajo sasi e vogël qytetari e ka kontejnerin, mundet me hedh vetë po një sasi e madhe aty ka shiringa, ka infuzione të ndryshme. Për korrektësi, ne muajmë tash pas seancën me i marr kamerat e me shku aty, aty duhesh me kry ti zotri Ramiqi, per urën ne kemi bisedu, ato që i kam kërku nëse nuk vinë në seancën e radhës prej seancës ka me shku ne Prokurori, këtë e ki të sigurt.

z.Milot Lala, drejtor i kulturës: Bekim, e thash edhe me herët e kemi vendimin të cilin e kemi bë edhe klubit "Vllaznia" për shfrytëzimin e hapësirave publike, sportive edhe klubit "Vitia". Unë e thash edhe me herët, që këto dy klube përballen me sfida të ndryshme për nga aspekti financiar dhe mbështetja e tyre. Tashti ata e përfaqësojnë vendin në mënyrën më të mirë të mundshme, janë ambasadorët më të mirë të komunës sonë, kështu që ti, unë e di ku e ki e ku po donë me e qit, shumë mirë e di këtë, po pikërisht ti duhesh mu kanë krenar për klubin e "Vllaznisë" dhe të "Vitisë", që po na përfaqësojnë në mënyrë më të mirë e jo me ja vështirësu punët me tendenca politike.

z.Bekim Azizi: Asnjë tendencë politike nuk e kam tek futbollit, tendencë ki ti. A e di që ti edhe drejtori para teje që u kanë drejtor i klubit, ju jeni të perzim drejtpërdrejt me atë klub, ai është klub privat. Unë po të lyp i a ki marrëveshje të nënshkruar që e shfrytëzon ai, sepse i ke investu 400-500 mijë euro pare të qytetarëve, klubi është privat, nuk është klub si i Pozharanit. Klubi i Pozharanit nuk është privat. Unë po ta kërkoj një marrëveshje të shkruar që e ki me klubin, unë tendenca nuk kam, e kush e ka klubin unë e di, ama kjo nuk qon peshë për mu, po marrëveshje që e ki ti si drejtori, sepse duhet me pas një marrëveshje.

z.Ekrem Abazi: Plotësisht e përkrahi Bekimin, kërkesat që i pate, se këtu po dyshoj është puna me dyshu, se këtu bëhen dallavere. Sa i përket stacionit të autobusëve, në këtë kuvend nuk ka kalu ajo marrëveshje, dy herë ne KPF-ne nuk e kemi kalu, kurrë dora ime si person, si këshilltar i këtij kuvendi, kurrë nuk votoj që stacionin e autobusëve ta merr Gjilani. Njerëzit tonë kanë kërku që ata me e marr stacionin e autobusëve ne mbikëqyrje. Unë kam kërku dy herë që ti ngarkojmë me një shume simbolike, ata që bëjnë shërbime në stacionon e autobusëve, po jo kurrsesi me e marr Gjilani. Pse, se këtu çdo punë që bëhet, bëhet për dallavere, për këtë po dyshoj.

Kryesuesi z. Naim Pira: Për seancën e tretë të rregullt të Kuvendi Komunal të Vitisë, kemi para këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-1373, të datës 29.12.2020, për miratimin e listës së veçante të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2021
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-98, i datës 01.03.2021, paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmase ankandit publik (parkingjet publike)

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-102, të datës 01.03.2021, për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-97, i datës 01.03.2021, për autorizimin e Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronave Komunale.

A ka dikush rreth rendit të ditës? Nga të gjithë u miratu rendit i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapë debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

z.Bekim Azizi: Tek faqja 13, rreshti 17, atje është lumi i gjatë 10m, po unë kam thanë i gjanë, këtu të përmirësohet.

Kryesuesi z.Naim Pira E hedh në votim procesverbalin me këtë vërejtjen e Bekimit. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë

z.Burim Sadiku, zyrtar komunal: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Pas kalimit të të gjitha procedurave, diskutimit publik për hartimin e rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë, janë kry të gjitha procedurat, e kemi sjellë në KPF, ku aty kemi pas një propozim nga z.Bekim Azizi, lidhur me neni 13, pika 4, që të tërhiqet kjo pikë, sepse është në kundërshtim me piken 1 te neni 13. Me që kemi konsideru me të drejtë, mirëpo ju materialin e keni marrë me atë pikë, po në rast të miratimin këtu, sekretaria e kuvendit e përgatit rregulloren pa atë pikë.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Hapi debat për këtë pikë.

z.Ali Bajrami: Unë nuk kisha vërejtje, po isha ndal tek neni 5, tek pika 5, kandidatët për pozita anëtare të këshillit lokal apo kryetaret të këshillit lokal, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur, emëruar në poste udhëheqëse, në struktura të subjekteve të partive politike. Këtu një shpjegim, kush ose çka nënkuptojmë me këtë.

z.Bekim Azizi: E përshëndes piken 4 te neni 13 që është terjek, se ka qenë e drejt mu hek dhe tek neni 3, unë kisha mendu këtu, që duhet të shtohet edhe një pikë që të shkruhet edhe per fshatrat që nuk kanë banor, se na e dimë që e kemi një pjesë të fshatit që nuk kanë banor, po i kemi të zgjedhur këshillat e fshatrave, duhet të specifikohet edhe kjo, sepse ne tek pikat tjera që i kemi, kur thotë anëtari e hup të drejtën nëse largohen nga vendbanimi, nëse nuk është banor i atij vendi. Po lidhem edhe tek disa vërejtje që i kam pa me vonë e nuk i kam dhanë me herët. Mendoj tek neni 6 duhet të plotësohet, sepse janë kur anëtarët e këshillit e humbin të drejtën, thotë plotësohet me vendimin çka janë aty, mirëpo tek kryetari nuk ka renditje. Unë mendoj duhet edhe këtu të shtohet pika 7, që kryetari të zgjidhet njëjtë sikur prej fillimit. Tek neni 12, tek financimi i aktiviteteve, këtu në pikën 1 shkruan, që financimin e aktiviteteve të këshillave të fshatit mund të behet nga vetë banorët, lagjet, nga komuna nga financimi i përbashkët me donator. Tash nuk janë përmendur format se si do të mbledhin e cila është çështja më e rëndësishme. Kur të mbledhen ato pare, a do të ketë këshilli i fshatit llogari bankare, a ka të drejt këshilli i fshatit me pas llogari bankare, apo do të obligohet këshilli i fshatit me dal me mbledh pare me dëftesa. Unë mendoj që të përcjellët këtu ana ligjore dhe te rregullohet tek pjesa e financimit, se nuk e dimi ne se si do te funksionon.

z.Jakup Demiri: Edhe unë po ndalem ku u lidhe Bekimi tek neni 12 dhe 13, tek puna e aktiviteteve, financimi i aktiviteteve të këshillit lokal nëpër fshatra nuk e kemi të rregulluar mirë, ndërsa tek neni 13, kemi fol edhe për pagesën e kryetarëve të këshillave lokale. Kjo ka mbet prapë qashtu qysh është, gjashtë takime paguhen gjatë vitit kalendarik dhe ata duhet të arsyetohen në aktivitete. A keni kërku që të gjendet naj model tjetër që të paguhen më shumë mëditje se gjashtë edhe të rritet pagesa.

z.Ekrem Abazi: Ata çka dashta me thanë e thanë parafolësit, po tek neni 13 unë kisha propozu, që kryetari i këshillit të fshatit të merr një pagë ose një mëditje se paku 100 euro mujore, me ditë që është kryetar i fshatit. Na një gjeneratë që kemi punu para luftës në mënyrë vullnetare kemi punu, e atëherë kemi pas vullnet me punu, sepse janë kanë rrethanat. Tash po mendoj që ka kalu koha e vullnetarëve aty ku mendoni ju që vetëm me vullnetar me kry punë aty punët nuk kryhet, nuk besoj përgjegjësi kryetari i fshatit nëse donë me punu, ka shumë përgjegjësi të mëdhaja, bile kam pas thanë me një kuvend para shtatë vite që ka përgjegjësi më të mëdhaja se ne që jemi këshilltar komunal. Nëse donë me punu për të mirën e fshatrave, po në kohën e fundit kryetarët e këshillave të fshatit po besoj që nuk janë pyet fare për prioritetet që i kanë për fshat edhe tash e kanë pa që nuk ka kurrëfarë vlere, mu kanë aty edhe ndoshta keni me pas vështirësi me gjetë dikan me bë kryetar të fshatit, sidomos tek ky neni që thotë mos mu kanë në parti politike. E dimë që në zgjedhjet e fundit ka pas probleme në fshatra për këtë qëllim kush mu zgjedh e si mu zgjedh, tashti po besoj që me këtë propozim që e keni bë nuk keni me mujt me gjet njerëz me bë kryetar ose këshill të fshatit. Po e përsëris, kisha propozu nëse e lejojnë rregullat e lojës se paku le dijet që e merr ai person një mëditje ose një pagë 100 euro në muaj.

z.Sejdi Emiri: Pajtohem me Ekremin, që minimumi le të jete 100 euro pagë mujore për administratorët e fshatrave, se funi i funit ata qaq po shpenzojnë dhe ne krejt çka po dojmë me bë shpenzimet e tyre, bile së paku te ja mbulojmë. E tek kjo që nuk duhet me qenë politik, absolut nuk pajtoj, se njerëzit që janë aktiv sigurish që janë edhe në politikë. Unë i kam këto kërkesa, që sa më shpejtë mu bë e obligueshme me i kompenzu ata, dhe qeta mos mu kane politik duhet me pas kujdes te këto.

z.Basri Sylejmani: E pyes nënkryetarin: a e lejon ligji me ju bë pagesa?

z.Ali Bajrami: Ata çka pata me thanë e ceku Basria, po nëse po bëjmë politikë dhe popollizëm, unë po thamë pak është 100 euro, po kjo rregullore është ne përputhje dhe në harmoni me ligjin, ligji e ka precizu që gjashtë paga. Na me shkel ligjin si këshilltar nuk duhet me e leju, ligjin nuk na lejon.

z.Ekrem Abazi: Absolut politikë nuk di me bë, nëse mendon tek unë mundësi me bë politikë, ju tjetër se unë po. Po unë thashë nëse doni me funksionu mirë. Kjo është rregullore e komunës e jo ligj. Ne me pas vullnet mujmë me gjetë burime se sa bëhen këto, sepse edhe nuk del shumë shumë e madhe.

z.Ali Bajrami: Unë mendoj që edhe rregulloret si kuvend komunal, këto rregullore duhet të bazohen në ligje dhe udhëzime administrative.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Çdo akt që miratohet nga ana e kuvendit janë akte nënligjore, të cilët bazohen në ligje. Absolut nëse dikush mendon që bimë akte, bimë vendime që nuk janë ne harmoni me ligjin, sepse ne e kemi MAPL-ne që e keshyrë ligjshmërinë e akteve, që i nxjerr kuvendi komunal, e nëse nuk janë në harmoni me ligjet, naj kthejnë në rishqyrtim dhe ne anulim, siç i kemi tash dy akte. Unë e di që vullnetin e kemi krejt që me i pagu kryetarët e këshillave të fshatrave.

z.Ekrem Abazi: Ali aga, unë e di çka është ligji, po aty janë specifikat e komunave, aty ki mundësi me intervenu komuna, po aty ku lejohet me pas çdo komunë specifikat e veta, atëherë mundet me ndërhy dhe ka me pran MAPL-ja.

z.Jakup Demiri: Përsëritet të nderuar koleg, përsëritet edhe për kryetarin i cili na u bashku. Është mirë me u ul ose me shty këtë rregullore që ta punojmë mirë, se perime një administrator i fshatit ka shumë punë, më shumë punë se gjithë njeri prej neve që jemi këshilltar edhe mos me ju ofru kompensim. Unë mendoj që duhet me u ulë me keshyr forma tjera të kompensimit. Unë kërkoj që le të shtyhet e ta përgatisim më mirë.

z.Ali Bajrami: Mirë që po pajtohemi, që duhet me ligj me qenë. Të kam thanë edhe më herët, po ta thamë prapë, në mesin tonë agallar nuk ka, unë jam shqiptar, emrin e kam Ali, prandaj atë epitet dhe atë emërtim, të lutem korrigjoe veten.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Unë po e shfrytëzoj rastin ta përshëndes edhe kryetarin i cili ju bashkëngjit punimeve të seancës, sepse ka qenë me një takim online.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje kryetar. Të nderuar këshilltar, të gjitha pyetjet pavarësisht keqkuptimeve të cilat muj me pas, po konsideroj që janë për me gjet një zgjidhje për ata që po i kryejnë punët në lokalitetin e vet. Megjithatë unë kam thanë njëherë, po e thamë përsëri, ne jemi në telashe ndoshta për mosrregullimin definitiv të ligjit, sepse ligji i cili po funksionon po i njuh dy pushtete, atë qendror dhe lokal, dhe këtë hallk naj ka lan sikur shoqatën “Nëna Terezë” ta quj kështu dhe kjo po e shohim se po paraqet pengesa në teren. Megjithatë unë i dëgjova shumicën, në këtë rregullore është një progres, se përderisa nuk kanë pas mëditje, atje me një nen e rregullon dhe thotë 6 mbledhje duhet të mbahen brenda vitit, që janë obligative dhe në ato mbledhje do ta merr një mëditje në përputhje me komitetin që e kanë. Prandaj është një lëvizje nga ajo rregulloja të cilën e kemi pas deri më sot, bilem shpenzimet që vjen ne Viti dhe ato shpenzime që i bënë kryetari me ja mbulu, po çështja tjetër që ta shtym rregulloren është e panevojshme, sepse këshillat e fshatrave janë tu funksionu dhe atë funksionalitet të tyre na duhet me mbulu me një akt të brendshëm, që akt i brendshëm është rregullorja, sepse e rregullon vetëm çështjen në Komunën e Vitisë, e cila është e harmonizuar në nivel të Kosovës me rregulloret të cilat do ti kenë të gjitha kuvendet komunale nëpër komuna të tyre. Neve nuk na bëhet vonë në momentin e aprovimit të buxhetit të vitit 2021. Për vitin 2022 ta shtrojmë kur ta aprovojmë buxhetin që të parashohim e të ja caktojmë një pagë të cilën ju po e kërkon, po jo sot, sepse nuk kemi të parapamë mjete, prandaj unë po konsideroj, që sot duhet të has në mirëkuptimin e juaj rregullorja e të miratohet, dhe në aprovim të buxhetit që do t'i bashkëngjitem mendimi i juaj me ja caktu një pagë simbolike, le të jete ajo, por megjithatë ta ketë një pagë simbolike, në mënyrë që ta stimulojmë që të bënë punën e vet me të mirë të mundshme në lokalitetin e vet dhe kur e bëjmë këtë, me kohë i ndajmë mjetet dhe mundet me hi ajo prej 1 janarit 2020. Kësaj rregullore ja bashkëngjite një vendim ne atë kohe kur t'i ndajmë mjetet dhe hecim më tutje.

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Faleminderit nënkryetar për këto sqarime dhe sqarimet që i kemi bë në KPF, në mënyrë që mëditja të shkon për kryetarin. Le të përmirësohet kjo, unë po e qes ne votim për miratim këtë rregullore, me ngritje dore. Nga të gjithë. Konstatoj që u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-1373, të datës 29.12.2020, për miratimin e listës së veçante të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2021

Kjo pikë ka qenë në seancën e fundit që insistua me fut si pik të rendit të ditës, për faktin që ka të interesuar për pronat që do të jepen ne shfrytëzim dhe me ligjin e ri do të kalojnë ne kuvend. Drejtoria e Kadastrit i ka sjellë këto prona. Unë po ja jap fjalën zyrtarit të drejtorisë që ta paraqes këtë pikë.

znj.Idajete Aliu, zyrtare e kadastrit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodizisë ka bë një propozim për plotësimin e listës së mëhershme, i kemi shti edhe tri zona kadastrale për dhënien në shfrytëzim. Këtu janë përfshi edhe Zona kadastrale e Vitisë, që përfshin parkingjet të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në dhënien në shfrytëzim në listë, Zona Kadastrale në Devajë. Kemi pas kërkesë për marrjen e disa pronave në shfrytëzim për energji të ripërtrishme dhe Zona Kadastrale në Goshicë, këto tri zona janë përfshi në plotësim të vendimit të mëhershëm.

z.Naim Pira, kryesues: Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë që jeni prezent miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-98, i datës 01.03.2021 paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmase ankandit publik (parkingjet publike)

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-110/05-102, të datës 01.03.2021, për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti

z.Naim Pira, kryesuesi: Këtë vendim naj kane kthy si pjesërisht të ligjshëm, për faktin që ne Zyrën e Personelit, Zyrën Juridike, Zyrën e Prokurimit i patëm hek dhe ata kanë kërku që duhet me qenë edhe këto. E tash e kemi bë edhe këtë ndryshim që e kanë kërku ministria, tash jemi të obliguar ta miratojmë. A ka dikush me diskutu për këtë pikë? Nëse jo, po e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:


6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 01-110/05-97, i datës 01.03.2021, për autorizimin e kryetarit të komunës për këmbimin e pronave komunale

z.Naim Pira, kryesues i kuvendit: Edhe këtë vendim jemi të obliguar ta shfuqizojmë. Hapi debat. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri



Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Naim Pira

